



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Senati Akademik

Nr. 2459 Prot

Shkodër, më 14.02.2025

V E N D I M

Nr. 208 datë 14.07 2025

"MBI RIALOKIMIN E BUXHETIT"

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar), Ligjit nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", VKM nr. 75, datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Udhëzimit nr.2 datë 24.01.2025 të MFE "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025", Udhëzimit të Përbashkët nr. 20, datë 20.9.2019 "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor, Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 14.07.2025,

Vendosi:

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2025, miratimin e transferimit të vlerës prej 200,000 lekë nga zëri Shpenzime për taksa dhe tatime të paguara nga institucioni me burim financimi të ardhurat, tek zëri Shpenzime printim publikimi me burim financimi të ardhurat.
2. Në buxhetin e miratuar për vitin 2025, zërat e investimeve të Departamentit të Arteve: Laboratori i fotografisë me vlerë 620,000 lekë, Laboratori i grafikës me vlerë 470,000 lekë të hiqen nga buxheti. Po tek investimet e Departamentit të Arteve Laboratori i multimedias i parashikuar me vlerë totale 4,172,000 leke nga ku 2,086,000 me fondet e AKKSHI dhe 2,086,000 lekë me të ardhurat e Universitetit, bëhet 5,028,000 lekë me burim financimi totalisht nga të ardhurat e Universitetit.
3. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim përfundimtar
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. Detajet në tabelën në vijim.

Zëri	Burimi i Financimit të Ardhura	
	Ishte	Behet
Shpenzime për tatime & taksa të paguara nga institucioni	674,900	474,900
Sherbime printim Publikimi	0	200,000
Pajisje laborator i fotografise	620,000	0
Laboratori i grafikës	470,000	0
Laboratori i Multimedias	2,086,000	5,028,000

Kryetari

Prof. Dr. Tahir Gjuraq